

ANILA OMARI

ÇËSHTJE TË FJALËKRIJIMIT NË VEPRËN E BOGDANIT

Kur Pjetër Bogdani iu vu punës për hartimin e veprës së tij madhore *Cuneus Prophetarum*, versioni i parë *Flavissae Prophetarum* përfunduar në vitin 1675, ishte në moshë të pjekur rreth 50 vjeçare. Dëshira e tij për të shkruar një libër në ndihmë të komunitetit të bashkatdhetarëve klerikë dhe lexues të ngritur ishte e madhe dhe e hershme. Por ajo që e kishte frenuar për ta ndërmarrë më herët nismën e shkrimit të një vepre të tillë, me një tematikë të pasur, jo vetëm fetare, por edhe teologjike, filozofike, diturore, letrare, ishte vështirësia e gjuhës shqipe. “Shqipja”, siç shprehej Çabej për epokën e Gjon Buzukut, “ishte atëhere – siç është gjer diku dhe sot e gjithë ditën – esencialisht një gjuhë me një fjalor të pasur me elemente që i përkasin jetës materiale, e të varfër me fjalë nga të sferës abstrakte të ideve”.¹ Për të kuptuar shqetësimin e Bogdanit për varfërinë e gjuhës me fjalë të leksikut abstrakt dhe sfidën që duhej të përballonte në hartimin e një vepre të atij niveli e përmasash, mund të citojmë fjalët e atij vetë: “tue kjanë vepëra fort e naltë, e hollë, giuha jonë qi me dijet dvuer ende fjalëtë, fëshfër mundetë gjithë punëtë ndjerë ndë skâjt me i çtjellë” dhe prandaj “sădo herë më ka rām dëshir gjākafshë me të shkruemit tem me sjellë mbë dritë, e kam pasunë mbajtunë ma fort për një tëndim, se për ndonji rreze të Shpirtit Shëjt.” Duke qenë kështu i ndërgjegjshëm për këtë vështirësi, ai i hyri punës për pasurimin leksikor të shqipes, e sidomos për krijimin e leksikut abstrakt të fushave të ndryshme të dijes. Në themelin e gjuhës letrare që ndërtoi Bogdani, qëndron një punë e mirëfilltë kërkimore. Ai shfrytëzoi disa mënyra për pasurimin e gjuhës: së pari, rigjallërimin i leksikut të vjetruar ose “fjalëve plaka e të harrueme” për t’i vënë në përdorim për qëllimet e veprës së tij; së dyti, krijimi i mjaft fjalëve të reja e neologjizmave, qoftë me brumin e shqipes e sipas modeleve fjalëformuese të saj, qoftë me lëndën e shqipes sipas modeleve të italishtes (kalke gjuhësore). Puna e tij krijuese përfshin edhe pasurimin me ngjyime të reja kuptimore të fjalëve të njohura duke zgjeruar sferën kuptimore të tyre. Krahës këtyre, së treti, ai ndoqi edhe rrugën më të zakonshme e të

¹ E. Çabej, *Gjon Buzuku*, në “Studime Gjuhësore” VI, Prishtinë, 1977, f. 35 (botuar së pari në Buletin për Shkencat shoqërore, nr. 1, 2, 3, 4, 1955).

drejtpërdrejtë të pasurimit të gjuhës, që është huazimi i termave të gatshme nga gjuhët e huaja, në radhë të parë nga italishtja.

Në këtë kumesë do të përqendrohem në pasurimin e leksikut të Bogdanit përmes krijimit të fjalëve të reja nga brumi i gjuhës shqipe, me mënyrat dhe mjetet fjalëformuese që ekzistojnë në shqipe. Me konceptin “fjalë të reja” nënkuptojmë ato njësi leksikore që dalin për herë të parë te Bogdani në raport me autorët e tjerë para tij, por që jo medoemos nuk ekzistonin në gjuhën shqipe të shekullit XVII. Përgjithësisht, lënda leksikore që kemi marrë në shqyrtim i takon leksikut abstrakt, asaj fushe për të cilën shqipja e kohës kishte më shumë nevojë. Sa ka qenë e mundur, kemi bërë edhe statistika për numrin e njërive leksikore për çdo mënyrë apo mjet fjalëformimi, dhe veçmas për numrin e njërive të reja që dalin për herë të parë në veprën e Bogdanit, duke nënkuptuar kjo një punë kërkimore tek të gjitha tekstet e vjetra shqipe paraardhëse të veprës së Bogdanit.

Për krijimin e leksikut abstrakt, autori vuri në përdorim mënyrat dhe mjetet fjalëformuese ekzistuese në gjuhën shqipe, si: prejardhja me parashtesa e prapashtesa, paranyjëzimi, konversioni, kompozimi, sipas modeleve fjalëformuese të shqipes. Ndër leksemat me kuptim abstrakt që solli Bogdani në tekstin e vet, në krahasim me autorët paraardhës, numri më i madh janë emra dhe mbiemra.

1.1. Për krijimin e emrave abstraktë, një rrugë formimi është emërimi i mbiemrave të nyjshëm, që formojnë emra asnjës, ndonjëherë edhe emra femërorë. Te Bogdani gjendet një pasuri e madhe *emrash prejmbiemërorë asnjës*² në krahasim me autorët paraardhës³, me një numër të përgjithshëm prej 67 njëvish leksikore, nga të cilat 30 janë përdorur për herë të parë prej tij në dokumentimin shkrimor të shqipes: **të blerë,-të** “gjelbërim: it. *verde*”; **të fështirë,-të** “vështirësi: it. *difficoltà*”; **të gërdisim,-itë** “shëmti: lat. *abominatio*, it. *abbominazione*”; **të gjymtë,-të** “gjymtim, cungim, sakatllëk”; **të marrë,-të** “marrëzi, it. *pazzia*”; **të mbarë,-të** “mbarim, qëllim i fundit: it. *fine*”; **të mposë,-të** “dallim: it. *distinzione*; veçanti: it. *modo particolare; singolarità*”; **të nkotë,-të** “kotësi, padobi,

² Disa nga këta emra asnjës që kanë temë me prapashtesën –të, e kanë shumë të zbehur kuptimin foljor, madje edhe tek autorët e vjetër, prandaj duhen interpretuar si emra prejmbiemërorë asnjës. Shih Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, USHT, Tiranë, 1972, f. 134.

³ Një vjelje të plotë të emrave prejmbiemërorë asnjës tek autorët e vjetër ka sjellë Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, f. 199-202.

punë e kotë: it. *ozio*”; **të njimendë,-të** “barazi, përputhje: it. *proporzione, concordia*”; **të njomë,-të** etj.

1.2. Një tjetër rrugë formimi është krijimi i emrave asnjans me paranyjëzim prej foljeve përkatëse. Me këtë mënyrë formohen veçanërisht emra abstraktë, por ndonjëherë edhe me kuptim konkret. Te Bogdani haset një numër i madh *emrash prejfoljorë asnjans* prej 196 njësisht leksikore. Nga këta emra 115 njësi leksikore përdoren për herë të parë prej tij në letërsinë shqipe. Pra Bogdani, në krahasim me letërsinë pararendëse, përdor më shumë se dyfishin e emrave asnjans, si me prejardhje mbiemërore, ashtu edhe foljore. Gjithashtu, shumë prej emrave ekzistues ai u ka zgjeruar vlerën kuptimore të fjalës. Emrat prejfoljorë asnjans në shqipen e shek. XVII tregojnë përveç se proces veprimi, edhe rezultat veprimi⁴, dhe në këtë kuptim përkojnë me emrat e sotëm mashkullorë me prapashtesën *-im* ose me femërorët më *-je* apo *-esë*, khs. p.sh. ***të ngranë,-të** “kafshim: it. *morso*”, **të hīm,-itë** “hyrje, it. *entrata*”, **të mbëluem,-itë** “mbulesë: it. *coprimento*”. Disa prej emrave prejfoljorë asnjans të përdorur së pari nga Bogdani, janë: **të adhëruem,-itë** “adhurim, it. *adorazione*” (krahas *adhërim*); **të ambëltuem,-itë** “ëmbëlsim”; **të amëshuem,-itë** “amëshim, përjetësi: lat. *æternitas*” (krahas *amëshim*); **të bajtun/ë,-itë** “të mbarturit, mbartje: it. *(il) portare*”; **të bubërruem,-itë** “kërkim i imtë, shqyrtim, qëmtim: lat. *scrutari*”; **të çtjellë,-të** “shitjellim, shpjegim: it. *spiegazione*”; **të çtrīm,-itë** “shtrirje, zgjatje: it. *stendere*”; **të çuëm ~ të nçuem**, “ngritje, ngjitje: it. *levazione*”; **të dejm,-itë** “dehje, të pirët”; **të depërtuem,-itë** “të përshkuarit, të shpuarit, depërtim”; **të dënuem,-itë** “dënim; dënim i përjetshëm, humbje e shpirtit: it. *perdizione (dell'anima)*”; **të dukunë** “dukje, shfaqje: it. *apparizione*”; **të dvarun/ë,-itë** “bjerrje, humbje, prishje: it. *perdizione*”; **të dvjerrë,-të** “humbje, bjerrje, shkatërrim: it. *perdimento*”; **të ecun/ë,-itë** “ecje: it. *(il) camminare*, lat. *egressus*”; **të fluturuem,-itë** “fluturim”; **të forcuem,-itë** “përforcim, pohim, konfirmim: it. *confermazione*”; **të frym,-*itë** “frymëzim, lat. *inspiratio*”; **të gām,-*itë** “ngjashmëri: it. *similitudine*” (krahas *gasë*); **të gërvishtuna** “gërvishtje: it. *laceramenti*”; **të ginë,-të** “të ngopur, të nginjur: it. *sazietà*”; **të gjëllitunë** “jetesë, rrojtje: it. *vivere; mantenimento*”; **të gjitm,-*itë** “bashkim: lat. *copula*”; **të hipun/ë,-itë** “ngjitje (lart): it. *ascensione*”; **të kallëzuem,-itë, të kjanë,-të**: Bogdani që i pari që e përdori këtë fjalë me

⁴ Në shqipen e sotme këta lloj emrash shënojnë kryesisht veprime abstrakte ose gjendje, dhe vetëm në ndonjë rast rezultat veprimi. Shih Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, USHT, Tiranë, 1972, f. 135.

kuptimet abstrakte të italishtes “Qenësi: it. *Ente*; lëndë, substancë: it. *sostanza*; të qenë: it. *essenza*; *essere*”; **të krijuem, -itë** “krijim: it. *creazione*”; **të kulluem, -itë** “pastërti: it. *nettezza*; kthjelltësi: it. *chiarezza*”; **të kundun/ë, -itë** “lëkundje; përmbytje: it. *diluvio*”; **të larguem, -itë** etj.

1.3. Bogdani ka përdorur gjerësisht edhe *formimet sintetike prapashtesore*, si mjete më koncize të shprehjes së rezultatit të veprimit. Në këtë grup hyjnë emrat mashkullorë të formuar prej foljeve me prapashtesën *-im*, me kuptimin e emrave të veprimit (nomina actionis), emra femërorë me *-esë*, emra femërorë me prapashtesën *-imë* dhe *-ë*. Këta emra ndeshen në shekullin XVII në sasi shumë më të vogël nga sa përdoren në gjuhën e sotme, por Bogdani e ka zgjeruar shumë fushën e përdorimit të tyre në krahasim me shkrimtarët paraardhës.

a) Emra mashkullorë prejfoljorë me prapashtesën *-im* të Bogdani janë 64 njësi leksikore, të cilat në shumicën e tyre përdoren për herë të parë prej tij. Mjaft prej tyre përdoren krahas emrave prejfoljorë asnjans, me të njëjtin kuptim të veprimit, por edhe të rezultatit të veprimit: **adhërim** “adhurim: it. *adorazione*; kult: it. *culto*” (krahas të *adhëruem*), khs. për kuptimin “kult”: II 142 5 u duknë rrënuem meçitetë idhujet, me adhërimp të tyre “si videro atterrati li Tempij, e deposto il culto delli Idoli”; **amëshim** “përjetësi: it. *eternità*, pavdekësi: lat. *immortalitas*” (krahas të *amëshuem*); ***bekim** “it. *benedizione*” (krahas të *bekuem*); **çkushëllim/çngushëllim** “dëshpërim: it. *dispiacere*; fatkeqësi: lat. *calamitas*”; **durim** “durim, këmbëngulje, përballim: it. *pazienza*, *perseveranza*, *sofferenza*”; **frujtim** “prodhueshmëri, pjellori, it. *fecondità*”; **gatim** “përgatitje e bukës e e gjellës”; **gëzim** “it. *allegrezza*; *delizia*”; ***gulshim** “dënesë, gulçim; dëshpërim”; **gjukim** “gjykim: it. *giudizio*; gjyq, proces gjyqësor: it. *causa*”; **kallëzim** “tregim historik: it. *historia*; tregim, kallëzim: it. *dimostrazione*; interpretim: it. *interpretazione*” (krahas të *kallëzuem, -itë*); **kastigim** “dënim: it. *castigo*”; **kërkim** “përshkim, udhëtim nëpër: it. *pellegrinaggio*; të provuarit e gjellës për shije: it. *gusto*” (krahas të *kërkuem* “shije: it. *gusto*); **kullim** “shkëlqim, bukuri: lat. *nitore*” (krahas të *kulluem* “pastërti: it. *nettezza*; kthjelltësi: it. *chiarezza*”); **kumbim** “tingëllim: it. *suono*”; **kungim** “it. *comunione*”; **martirixim** “it. *martirio*”; ***mashtim** “it. *inganno*”; **mbarim** “qëllim; fund: it. *fine*” (krahas të *mbaruem* “mbarim, fund: it./lat. *fine*”); ***mbukurim** “zbukurim: it. *ornamento*”; ***meritim** “meritë: it. *merito*” (krahas të *meritueme* me të njëjtin kuptim); **mpsim/ mbsim** “mësim, doktrinë: it. *dottrina*” (tashmë pa konkurrencën e prejfoljorit asnjans); ***mundështim** “mundim; ndëshkim: it. *punizione*”; **ndërrim** “ndryshim, shndërrim: it. *cangiamento*, *mutazione*”

(krahas të *ndërruem* “ndryshim; transformim: it. *mutamento*; *rimforma*”); **ndëshkim** “masë dënimi, dënim: it. *punizione*, *castigo*” (pa konkurrencë të asnjënjësit); **ngarkim** “barrë: it. *gravidanza*” (krahas të *ngarkuem* me të njëjtin kuptim); ***ngatërrim** “ngatërresë: it. *intrigo*”; **ngurim** “ngurtësi, këmbëngulje, papërkulshmëri: it. *durezza*” (krahas të *nguruem* me të njëjtin kuptim); **ngushëllim** “lehtësim i dhembjes, ngushëllim: it. *conforto*, *solievo*; *consolazione*; lavdi: it. *gloria*; gëzim: it. *allegrezza*; lumturi: it. *felicità*” (krahas të *ngushëlluem* “*consolazione*”) etj.

b) Emrat prejfoljorë femërorë me prapashtesën **-esë**, që shprehin rezultat veprimi, e në një rast edhe kuptim konkret, te Bogdani gjithashtu janë dyfishuar në krahasim me autorët paraardhës. Ndeshen gjithsej 12 njësi, nga të cilat 6 përdoren për herë të parë: **harresë**, **manesë**, **ndivënesë**, ***ngjitesë** “gjë e ngjitur: it. *cosa glutinosa*”, **përmetesë**, **vollëndesë**.

c) Derivatë foljorë të gjinisë femërore me prapashtesën **-më/-imë**, me kuptimin e rezultatit të veprimit, janë gjithsej 11 njësi leksikore, nga të cilat 6 përdoren për herë të parë te Bogdani: **britmë**, **corkëllimë** “stridor”, **reshëtimë** “reshje”, **rrafshëtimë** “rrafshinë: it. *pianura*”, **rrapëtimë** “zhurmë, rrapëllimë: it. *rumore*, *strepito*”, ***tingëllimë** “it. *suono*”.

d) Emra femërorë prejfoljorë me prapashtesën **-ë**, që në gjuhën e sotme u përgjigjen emrave femërorë me **-je**, te Bogdani janë 10 njësi leksikore: **cpifë** “shpifje”; **dekë** “vdekje: it. *morte*”; **dokë** “përdorim i përditshëm, zakon: it. *uso*”; **gasë** “ngjashmëri: it. *similitudine*, *somiglianza*”; **kënaqë** “kënaqësi: it. *delizia*”; **ndenjë** “vendbanim, banesë: it. *abitazione*” (krahas emrit asnjënjës të *ndenjunë* “1. përendim: it. *tramonto*; 2. vendbanim, seli: it. *residenza*”); **shitë** “paralizë, shuplakë zanash, lumbago: it. *sciatica*”; **trembë** “frikë: it. *spavento*”; **veshë** “veshje: it. *vestito*”; **vrasë** “vrasje masive, kasaphanë, kërdi: it. *strage*” (krahas të *vrām* “vrasje”). Thuajse të gjitha këto fjalë janë përdorur për herë të parë prej tij në letërsi. Para tij Budi ka *kënaqë*, *mërzitë*.

e) Emra abstraktë të formuar prej mbiemrave dhe emra të formuar prej foljeve me prapashtesat **-me** dhe **-e** që tregojnë rezultat veprimi ose që kanë kuptim konkret, gjenden edhe në gjininë femërore, nga të cilat hasen së pari te Bogdani: **dënesme** “dënesë: it. *singhiozzo*, lat. *fletus*”; **dredhe** “erë e fortë që rrotullohet rreth vetes, ciklon: it. *turbine*”; **e dridhme** “zhurmë dridhëse, rrapëllimë: it. *strepito*”; **hae** “e ngrënë, gjellë: it. *(il) mangiare*”; **të ndaluna** “ndalesa: it. *stazioni*”; **e pagaeme** “gjë e paparë, e padëgjuar, e tepruar”; **e paudhë** “parregullsi, paudhësi, prapësi: it. *disordine*, *irregolarità*”; ***e përgjegjunë** “përgjigje: it. *risposta*”; ***e sjellë** “1. sjellje, mënyrë të sjelli, ceremoni: it. *cerimonia*; 2. goditje: it. *colpo*”;

***e shtëmajtë** “e majta: it. *sinistra*”; **e shtremënë** “e gabuara”; **e vërtetë** “it. *verità*”; ***e vogëlë** “vogëlsi: it. *piccolezza*”.

f) Te Bogdani ka marrë zhvillim të madh edhe tipi i fjalëformimit me prapashtesat **-t̃**, **-ñt̃**, **-r̃t̃**, e në ndonjë rast edhe **-t̃t̃**, që shënojnë emra përmbledhës dhe emra abstraktë cilësie të gjinisë femërore. Në tekstin e tij dalin 79 emra të tillë, nga të cilët 40 përdoren për herë të parë në letërsi. Me prapashtesën **-t̃** janë formuar: **bujërt̃** “parësia, krerët e vendit, pleqësia, it. *senato*” (nga emri *bujar*); **fëlliqëshit̃** e. f. “ndyrësi, fëlliqësi: it. *immondizia, sozzura, lussuria*” (nga mbiemri i *fëlliqësht*); **grykës̃t̃** “it. *gola*” (nga mb. *grykës*); **hīt̃** “nxitim: it. *fretta*” (formim prapavajtës nga folja me burim sllav *hitas* “nxitoj”); **idhullat̃r̃** “adhurim i idhujve: it. *idolatria*” (mund të jetë formim nga *idhullatër* me ndikim të it. *idolatria*); **kundërsht̃** “të qenët në kundërshtim me njëra-tjetrën, mospajtim: it. *antiperistasi, contrasto, contrario*” (nga folja *kundërshtoj*); **madh̃t̃** “madhëri, madhështi: it. *maestà*” (nga mb. i *madh*); **mixor̃t̃** “mizori: it. *crudeltà*” (nga mb. *mixuer, mixor*); **mjer̃t̃** “mjerim: lat. *miseria*” (nga mb. i *mjerë*); **nierëz̃t̃** “1. bota, gjindja; qytetërim: it. *civiltà*; 2. mirësjellje, njerëzillëk: it. *cortesia*; modesti, thjeshtësi, vetëpërmbajtje: it. *modestia*; *gravità*; 3. të qenët njeri, karakteristikat njerëzore: it. *umanità*” (nga shumësi emëror *njerëz*) etj.

Me prapashtesën **-ñt̃** janë krijuar nga tema emërore e mbiemërore: **amënt̃** “të qenët nënë, amësi”; **barrënt̃** “shtatzani: it. *gravidanza*”; **bijënt̃** “birëri: it. *figliolanza, filiazione*”; **burrënt̃** “mosha e burrit: it. *età virile*”; **dekënt̃** “vdekje, gjendja e të vdekurit: it. *mortalità*” dhe formimi privativ me prapashtesën **pa-** **padekënt̃** “pavdekësi: it. *immortalità*”; **hyjënt̃** “it. *divinità*”; **mjerënt̃** “mjerim: it. *miseria*”; **shëjtënt̃** “it. *santità*”; **shtâsënt̃** “kafshëri: it. *bestialità*”; **shterrënt̃** “shterpësi: it. *sterilità*”; **vajzënt̃** “moshë e vajzërisë: it. *fanciullezza*; virgjëri: it. *verginità*”; **zonjënt̃** “fisnikëri: it. *signoria*”.

Janë formuar me prapashtesën **-r̃t̃**: **bashkërt̃** ~ **bashkar̃t̃** “bashkim, lidhje: it. *lega*; përkim: it. *convenienza*; përzierje: it. *mistura*”, nga ndajfolja *bashkë*; **lavdërt̃** “kërcënime: it. *minacce*”, nga emri *lavd* “kërcënim”; dhe me prapashtesën **-t̃t̃**: **lodërt̃t̃** “vegël muzikore: it. *strumento*; fig. muzikë: it. *suono*” (nga *lodër*).

1.1.4. Bogdani përdor dhe një numër *formimesh me strukturë të pathjeshtë*, kompozita e fjalë të përngjitura, disa nga të cilat janë të gjuhës popullore e disa të tjera mund të jenë formuar prej tij në bazë të modeleve të shqipes. Përveç kompozitave që gjenden edhe tek autorët e mëparshëm, Bogdani përdor për herë të parë në letërsi formimet e përbëra, mjaft të

ngjeshura semantikisht, **bajbukës** (it. paniere), me gjasë një neologjizëm i tij, ***barkkeq** “i pangopur: it. intemperato”, **barkthatë** “sterile”, **i gjithëpushtueshim** “onnipotente”, **i gjithëherëshim** “i përjetshëm: it. perpetuo, i vazhdueshëm: it. continuo”, **hanëplote** “plenilunio”, **jetëgiatë** “di più longa vita”, **kripzez** shm. “con capelli neri”, **parëbijënt** “gjendja ose të qenit i parëlindur: it. primogenitura”; **shkalëbaltë** “njeri që e shkel bota me këmbë, i përbuzur, i ulët, turpi i botës: it. vile, lat. opprobrium hominum”, **shtatpëlqerëtë** “shtatshkurtrit, xhuxhat, pigmejtë”, ***vepërëkeq** (it. d’opere cattivi), si dhe foljen **me u rrethprem** “bëj synet: it. circoncidere” dhe derivatin përkatës emëror asnjënjës **të rrethpremitë** “synet: it. circonCISIONE”, një term ky i farkuar sipas modelit të italishtes *circoncidere*.

1.2. Një zhvillim të rëndësishëm ka njohur në gjuhën letrare të Bogdanit përdorimi i **mbiemrave**. Në procesin e krijimit të mbiemrave, për të dhënë kuptime të reja përcaktuese të emrave, kuptime dytësore apo ngjyrimë kuptimore, Bogdani shtiu në përdorim gjerësisht parashtesat, si **për-** e **pa-**, dhe prapashtesat, nga të cilat bie në sy përdorimi i prapashtesës **-shim**. Lidhur me mbiemrat prejpjesorë me prapashtesën **-shim**, ia vlen të ndalemi në një dukuri që vihet re në këtë fazë më të vjetër të shqipes. Nga teksti i Bogdanit shihet se është ende i paqartë diferencimi semantik i mbiemrave prejpjesorë⁵ të formuar thjesht me nyjëzim, që në gjuhën e sotme letrare kanë kryesisht kuptim pësor⁶, me mbiemrat prejfoljorë me prapashtesën **-shim**, me kuptim kryesisht vepror ose mundësor⁷, pasi përdoren pa dallim dhe me të njëjtin kuptim: *i mërekulluem* krahas *i mërekullueshim* “meraviglioso”, *i hyjënuem* krahas *i hyjënueshim* “Divino”, *i ngushëlluem* “glorioso, soave, giocondo” krahas *i ngushëllueshim* “i lavdishëm: it. glorioso”, *i papām* dhe *i papashim* “i padukshëm: it. invisibile”, *i ardhunë* me kuptim mundësor “i ardhshëm: it. venturo”, *i padashunë* “i pamëshirshëm: it. crudele; mosmirënjohës: it. ingrato”, *i padhimtunë* “mizor, i pamëshirshëm: it. crudele”, *i palëkundunë* “i palëvizshëm, i patundur: it. immobile”, *i pamënë* “që s’meh (s’mбетet, s’pushon) kurrë; i palodhshëm: it. infatigabile”, *i panjefunë* “i panumërt: it. infinito, innumerevole; i panumërueshëm: it. innumerabile”, *i paxgidhunë* “i pazgjidhshëm: it. indissolubile”, *i*

⁵ Shih V. Memisha, *Rreth normës leksikore, semantike e morfologjike të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, në “Studime për fjalën shqipe”, QSA, IGJL, Tiranë, 2011, f. 40.

⁶ Shih *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHRSH, IGJL, Tiranë, 1995, f. 196.

⁷ Po aty, f. 194.

ndërruem “i ndryshueshëm: it. *mutabile*”, *i mërziçim* me kuptim vepror “i mërzitshëm, i bezdisshëm: it. *rincrescevole*, *fastidioso*” por edhe pësor “i urryer: it. *abominevole*”, *i dhimtëshim* “i dhembshëm: it. *doloroso*; i dhembshur, i mëshirshëm, përdëllimtar: it. *pietoso*” por edhe “i hidhëruar: it. *addolorato*”, *i ndershim* “i ndershëm: it. *onesto*; i respektueshëm: it. *venerabile*”, por edhe “i nderuar: it. *onorato*; i denjë për nderim: it. *onorevole*”. Një dukuri e tillë vihet re edhe në shkrimet e mëvonshme të shek. XVIII, p.sh. te Dhaskal Todhri: *perëndiileemeja* “hyjlindësja”, *ndeerbami* “bamirësi”, *jetëbaami* “jetëdhënësi”, *perëndii-ruajtmi* “i ruajturi nga perëndia”⁸ etj.

Por nga ana tjetër, ka raste kur bëhet qartë dallimi midis kuptimit vepror dhe atij pësor në formimet e ndryshme mbiemërore me të njëjtën temë foljore, si në shembujt *i trembshim* “i tmerrshëm: it. *terribile*, *spaventoso*” dhe *i trembunë* “i frikësuar: it. *impaurito*”, *i dëshëruem* “*desideratus*”: I 151 2 *e ka me ardhunë i dëshëruemi i gjithë gjindsë*, dhe *i dëshërueshim* “i dëshëruar: it. *desideroso*” II 98 2 *Shëlbuesi ynë gjithë i dëshërueshim për të dvekunë vetë*, si dhe përdorime të qarta me kuptim vepruesi, si në gjuhën e sotme: *i dukshim* “i qartë, që duket qartë: it. *trasparente*; jo i vërtetë, që është vetëm në dukje, në pamje të parë: it. *apparente*”, *i durueshim* “që ka durim; që duron shumë: it. *paziente*”, *i frujtueshim* “pjellor: it. *fecondo*; i dobishëm”, *i hieshim* “i hijshëm, i pëlqyeshëm: it. *grazioso*”, *i mbarshim* “i turpshëm, që ka turp: it. *verecondo*”, *i ndriçim* “*luminoso*”, *i padurueshim* “*fastidioso*”, *i pakalbshim* “*incoruttibile*”, *i pëlqyeshim* “*piacevole*” etj.

Përdorimi i mbiemrave prejfoljorë me *-shim* me kuptim thjesht të një tipari cilësor dhe me kuptim pësor, që vihet re te Bogdani, ka ardhur duke u shtuar në gegërishten e re si një tipar karakteristik i saj, ndërsa në toskërishte përkundrazi, ka ardhur duke u shtuar përdorimi i mbiemrave të formuar nga nyjzimi i pjesores me kuptim vepror, si një tipar i këtij dialekti. Ashtu si në dukuri të tjera, edhe këtu dy dialektet kryesore të shqipes kanë shkuar në rrugë divergjente.

Pasuria leksikore e veprës së Bogdanit, si pasqyrë e erudicionit të autorit, është një nga vlerat më të mëdha të veprës, që e bën atë monumentin ndoshta më të rëndësishëm gjuhësor të shqipes së vjetër (shek. XVI-XVII)⁹.

⁸ Khs. Liturgia e Shin Gjon Gojartit, botuar nga Lef Nosi, “Dhaskal Todhri”, *Kopështi Letrar*, nr. 1, 1918 f. 14, f. 13, f. 2.

⁹ Pasurinë leksikore të veprës së Bogdanit e kanë vlerësuar të gjithë albanologët që e kanë njohur dhe studiuar atë, që në fillimet e njohjes me tekstet e vjetra shqipe.

Çështje të fjalëkrijimit në veprën e Bogdanit

Në qoftë se Naim Frashëri dhe rilindasit e tjerë në punën e tyre për pasurimin e gjuhës shqipe patën ndoshta si frymëzim dhe model mendimet e filozofit të madh gjerman Leibnizit për lëvrimin dhe përmirësimin e gjuhës gjermane¹⁰, Pjetër Bogdani i zbatoi metodat e pasurimit të shqipes ende para daljes në dritë të veprës së Leibnizit¹¹.

Shqetësimi dhe kujdesi për gjuhën amtare, puna e gjerë krijuese e lëvruese me gjuhën është një tipar që e rendit Pjetër Bogdanin ndër pararendësit e Rilindjes Kombëtare.

Kështu, N. Jokli që në vitin 1911 në veprën *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*, Wien, 1911, f. 2, vë në dukje “një buri fjalësh” që gjenden te Bogdani (cit. sipas përkthimit të E. Çabejt, në: N. Jokl, *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip*, ASHAK, Prishtinë, 2011, f. 23).

¹⁰ Khs. N. Jokl, “Naim Be Frashëri dhe pasunimi i gjuhës shqipe”, Gjurmime albanologjike, seria filologjike II-1972, Prishtinë 1974, f. 21. Shih edhe Sh. Demiraj, *Roli i Naim Frashërit në zhvillimin e shqipes letrare*, <http://floripress.blogspot.al/2013/09/roli-i-naim-frasherit-ne-zhvillimin-e.html>.

¹¹ G. Leibnitz, “Unvorgreifliche Gedanken betreffend die Ausübung und Verbesserung der deutschen Sprache”, 1697, khs. N. Jokl, art. i cit., f. 21. (Vepra e Leibnizit mund të lexohet online si ribotim nga Ch. G. Ackermann, Dessau 1831 në:

<https://books.google.al/books?id=kZAOAQAAMAAJ&printsec=frontcover#v=onepage&q&f=false>)

